VENDIM
Nr. 58, datë 3.10.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "MBI RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË SIPAS SISTEMIT RAPORTUES TË UNIFIKUAR"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", nenit 43, shkronja "c", nenit 27, nenit 58, nenit 70, pika 1, dhe nenit 71 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 47, pika 4, dhe nenit 126, pika 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neneve 43, pika 3, dhe 62, pika 1, shkronja "c", dhe nenit 72, pika 5, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.05.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 10.6.2009, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 6, pika 1 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

"Ndryshimet në sistemet raportuese mund të propozohen prej njërit nga departamentet e mëposhtme:

a) Departamenti i Statistikave Financiare;

b) Departamenti i Mbikëqyrjes;

c) Departamenti i Politikës Monetare;

d) Departamenti i Operacioneve Monetare;

e) Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Për çdo ndryshim në sistemet raportuese, departamentet e përcaktuara në shkronjat "b", "c", "d" dhe "e" të kësaj pike bashkëpunojnë me Departamentin e Statistikave Financiare.".

b) Në nenin 11, pika 2 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

"2. Raportimi për subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unioneve të tyre sipas kësaj rregulloreje bëhet në formë shkresore dhe në formë elektronike.".

c) Në nenin 11, pika 2/1 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

"Raportimi nga subjektet banka bëhet në formë elektronike nëpërmjet Sistemit Elektronik Raportues Rregullator - ERRS.".

d) Në nenin 11, pika 3 shfuqizohet.

e) Në nenin 11, pika 5 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

"Çdo fletë e plotësuar e formularit të sistemeve raportuese për subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursimit dhe unionet e tyre duhet të përmbajë gjenealitetet dhe nënshkrimin e specialistit të subjektit përkatës raportues, që përgatit këtë raportim.".

f) Formularët F40, F41, F42, F43 bashkëlidhur kësaj rregulloreje shfuqizohen.

g) Miratohet formulari F49 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Statistikave Financiare dhe Departamenti i Mbikëqyrjes, në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko